

# Konsumi privat në Kosovë 2003-2005

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) mat në mënyrë të vazhdueshme konsumin privat nëpërmjet Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF). Këto statistika janë të nevojshme për të përcaktuar shportën për Indeksën e Çmimeve Konsumuese (IÇK), konsumin privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) dhe analizimin e mirëqenies dhe varfërisë. Anketa gjithashtu mat edhe arsimimin, punësimin, kushtet e banimit, pronësinë e mallrave të qëndrueshme, ndërtimin dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me bizneset dhe kultivimin e tokës. Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2 400 ekonomi familjare në vit të zgjedhura sipas rastit dhe në pajtim me standardet e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është më e lartë se 80% nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Shtator, 2006

## Hyrje

Llogaritë Kombëtare (LLK) mund të vlerësohen më të dhënat mbi prodhimin, të dhënat mbi konsumin apo të dyja këto. Në vendet mjaftë të zhvilluar njeriu mund të mbështetet kryesisht në të dhënat mbi prodhimin dhe ABEF-ja shfrytëzohet për të kontrolluar apo kalibruar rezultatet. Në shumicën e shteteve të zhvilluara dhe ato në transit të dhënat mbi prodhimin janë të kufizuara, të vjetruara apo të një kualiteti të dobët. Në këto shtete LLK-të duhet të mbështeten në ABEF-në si burim kryesor të informacionit.

Ky artikull paraqet të dhënat makroekonomike nga ABEF 2003-2005. Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga LLK-të, pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të KKIQ-së – Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit.

Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta. Përqindja e shpërndarjes së konsumit në nivelet e grumbulluara duhet të jetë disi më e madhe. Ndryshimet në kohë kanë ndodhur për shkak të gabimit të rastit si për periudhën e fillimit ashtu edhe për atë të përfundimit. Bruto Konsumi Vendor është po ashtu i ndërlikuar. Përveç të metave në matësit ekonomik ai gjithashtu varet nga të dhënat e besueshme demografike. ABEF-ja dhe anketat tjera sugjerojnë një popullsi më të vogël dhe një rritje më të ngadalshme sesa parashikimet zyrtare për popullsinë të bazuara në supozime. Pa një regjistrim të ri të përgjithshëm të popullsisë është vështirë që të bëhet ndonjë vlerësim.

## Rritja e ngadalshme ekonomike?

Sipas anketës konsumi i përgjithshëm privat përfshin ushqimin e prodhuar vendor më një rritje prej 2.4 % nga viti 2003 në vitin 2004 dhe prej 1.3 % ndërmjet vitit 2004 dhe 2005.

Konsumi privat për ekonomi familjare është rritur pothuajse 4 % ndërmjet vitit 2003 dhe 2004 dhe 6 % ndërmjet vitit 2004 dhe 2005. Konsumi për kokë banori është rritur për më shumë se 14 % nga viti 2003 në vitin 2005. Mundësitë ekonomike për çdo ekonomi familjare dhe për çdo person janë rritur bukur shumë (në mesatare). Rritja e ngadalshme shpjegohet sipas disa ekonomive familjare dhe numrit të zvogëluar të anëtarëve të ekonomive familjare sipas ABEF-së. Duke ndërlidhur parashikimet zyrtare me rritjen vjetore të popullsisë për 1.7 %, konsumi i përgjithshëm privat ndërmjet vitit 2003 dhe 2005 është rritur për 17 %.

Në vitin 1999 konsumi i përgjithshëm ka ndryshuar brenda BE-së ndërmjet 20 000 dhe 30 000 €.

**Tabela 1 Konsumi i përgjithshëm privat në Kosovë 2003-2005**

Viti	Milion €	Konsumi për ekonomik familjare €	Konsumi për kokë banori €
2003	1 493	5 400	840
2004	1 529	5 600	910
2005	1 549	5 900	950

**Tabela 2 Numri i ekonomive familjare dhe madhësia mesatare e ekonomisë familjare në Kosovë 2003-2005**

Viti	Ekonomitë familjare	Madhësia e ek. fam
2003	278 000	6.4
2004	275 000	6.1
2005	262 000	6.2

## Shpërndarja e konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar në ushqim me 40 % të konsumit të përgjithshëm. E dyta është banimi me më shumë se 30 % dhe vendin e tretë e zënë transporti dhe rrobat me 6 %. Pjesa për ushqimin është zvogëluar gjatë viteve dhe kjo mund të shihet si një shenjë e një standardi më të lartë ekonomik. Me rritjen e standardit njerëzit shpenzojnë më shumë para në ushqim por pjesa e buxhetit zvogëlohet (Ligji i Engelit). Transportet zakonisht ngritën më përmirësimin e ekonomisë. Konsumi i ushqimit në vitin 2003 është paksa mbivlerësuar, për shkak të mënyrës së ndryshme të matjes së ushqimit të prodhuar vendor krahasuar me vitet tjera.

Rreth 10 % e konsumit të përgjithshëm përfshin ushqimin nga prodhimi vetanak dhe 20 % e të gjithë ushqimit të konsumuar është ushqim nga prodhimi vetanak.

Shumica e shtëpive në Kosovë janë të banuara nga pronarët. Për ta, sipas standardeve ndërkombëtare në vend të çmimit aktual është vlerësuar vlera e mirëqenies së banimit. Çmimet aktuale rrallë e pasqyrojnë vlerën e vërtetë.

Shifrat e fundit të krahasuara nga BE-ja nga viti 1999 dhe për 14 shtetet anëtare tregojnë se ndryshimet më të theksuara janë në ushqim, transporte, rekreacion dhe hotele dhe restorante.

**Tabela 3 Shpërndarja e konsumit në Kosovë 2003-2005**

Konsumi	2003	2004	2005
Ushqimi	48%	43%	40%
Alkooli & duhani	3%	3%	4%
Rrobat	5%	5%	6%
Banimi	29%	31%	31%
Furnizimi	4%	3%	4%
Shëndetësia	1%	2%	2%
Transporti	4%	5%	6%
Komunikimi	1%	2%	2%
Rekreacioni	1%	1%	1%
Arsim	1%	1%	1%
Hotele & restorante	1%	1%	1%
Të ndryshme	2%	2%	3%
	100%	100%	100%
<i>Ushqimi i prodhuar vendor</i>	13%	9%	9%

**Tabela 4 Shpërndarja e konsumit në BE në vitin 1999**

Konsumi	Min	Maks
Ushqimi	10%	19%
Alkooli & duhani	2%	7%
Rrobat	5%	9%
Banimi	20%	31%
Furnizimi	5%	8%
Shëndetësia	1%	6%
Transporti	10%	17%
Komunikimi	2%	3%
Rekreacioni	5%	15%
Arsim	0%	2%
Hotele & restorante	4%	10%
Të ndryshme	5%	15%

Burimi: ABEF 1999, Eurostat

## Konsumi i ushqimit

Ushqimi në Kosovë dominohet nga buka, ushqimi nga drithërat, produktet ditore dhe vezët dhe që kontribuojnë në pothuajse gjysmën e konsumimit të ushqimit (në vlerë). Kjo pasohet nga pjesët e barabarta për mish dhe perime (secila 12 %).

Ndryshimet përgjatë kohës nuk janë të rëndësishme në aspektin statistikor.

Në fakt mostrat e ushqimi po ndryshojnë shumë ngadalë prandaj pjesët për ushqim mund të shfrytëzohen si indikator i kualitetit të anketës. Pjesët janë shumë të qëndrueshme gjatë kohës dhe tregojnë një kualitet të lartë të të dhënave së paku për pjesën e ushqimit.

**Tabela 5 Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2003-2005**

Konsumi	2 003	2 004	2 005
Buka dhe drithërat	22%	21%	23%
Mishi	12%	13%	12%
Peshku	1%	1%	1%
Produktet ditore, vezët	23%	22%	21%
Vajrat dhe yndyrat	4%	5%	4%
Frutat	6%	7%	7%
Perimet	13%	13%	12%
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	6%	5%	6%
Produktet e ushqimit	5%	5%	5%
Pijet jo alkoolike	8%	9%	9%
Ushqimi i përgjithshëm.	100%	100%	100%

## Konsumi dhe shpenzimet

Shumica e konsumit është arritur duke shfrytëzuar paratë. Konsumi i paguar (shpenzimi i konsumit) është rritur për 8 % ndërmjet vitit 2003 dhe 2004 por pastaj ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit 2005. Vlera e mirëqenies së shtëpive vazhdimisht po rritet për 3% në vit. Konsumi tjetër jo shpenzues (ushqimi i prodhuar vendor dhe i marrë, drutë për ngrohje dhe rrobat) është paksa zvogëluar. Shpenzimi jo konsumues kryesisht është rritur nëpërmjet vendosjes së tatimit në rroga dhe vjeljes së rritur të tatimit në vetura.

**Tabela 6 Konsumi dhe shpenzimet në Kosovë 2003-2005, miliona €**

Viti	Shpenzimi i konsumit	Qiraja e vendosur	Konsumi tjetër jo shpenzues	Shpenzimi jo konsumues
2003	959	351	183	2
2004	1 037	361	132	4
2005	1 038	372	139	20

Ne ftojmë të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi për bashkëpunim, dhe ju lutemi që për komentet dhe sygjerimet tuaja, të kontaktoni Departamentin e Statistikave Sociale, përkatësisht Sektorin e Standardit Jetësorë përmes telefonit: 038/235 148, 038 235 136 ose përmes adresës: [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net) dhe vizitoni vebfaqen tonë: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)